

Shpallje për

Trajner/e për Trajnimin për ndërmarrësi

YMCA është duke bërë implementimin e projektit “1 me 1” i financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Qëllimi kryesor i këtij projekti është të ju mundësoj të rinjëve/rejave në të ardhmen të jenë më të përgatitur për tregun e punës dhe të pajisen me aftësitë dhe njohuritë për të qenë ndërmarrës të ri/reja. Implementimi i këtij projekti ka filluar nga periudha Janar, 2022 – Maj, 2022.

Komponentët kryesore të programit të YMCA-së janë si në vijim:

- Të kontribuojmë në zhvillimin e drejtëpërdrejtë të aftësive të rinisë.
- Të ndihmojmë të rinjtë/rejat të bëhen më të punësueshëm.
- Të ndikojmë në vetëbesim përmes mentorimeve/udhëzimeve.
- Të krijojmë hapësirë që të rinjtë/rejat të fitojnë aftësi për punësim ose vetëpunësim.
- Të rinjtë/rejat do të kenë mundësi të jenë ndërmarrës të rinj/reja dhe të krijojnë vende të reja të punës për njerëz të tjerë.
- Të kontribuojmë duke u ndihmuar të rinjve/rejave për orientimin në karrierë.
- Ndikim pozitiv në ekonominë lokale.

YMCA Movement – YMCA Lëvizje shpall konkurs për pozitën e Trajner/e.

Shërbimi për këtë trajnim kërkohet të angazhohet nga periudha 15 Prill, 2022 – 15 Maj, 2022. Kandidatët e suksesshëm do të ftohen në intervistë nga ku edhe do të përcaktohet angazhimi i tyre.

Ju lutem dërgoni aplikacionet e juaja (CV-në dhe letrën motivuese) në gjuhën Angleze apo Shqipe, si dhe ofertën financiare me Emrin dhe Mbiemrin e kandidatit si dhe pozitën e cituar në Subject line: Trajner/e për Trajnim në Ndërmarrësi, prej 31 Mars, 2022 deri më 13 Prill, 2022, ora 17:00 p.m, përmes e-mailit: office@ymcacosovo.com me subject line , kontaktimi përmes formave të tjera të komunikimit nuk do të merret parasysh.

Kandidatët të cilët përmbushin kërkesat të cilat janë të paraqitura në shpallje do të ftohen në intervistë. Ju lutem vini re se aplikacionet e pranuar pas afatit nuk do të konsiderohen.

Për më shumë informata ju lutemi shihni Termat e Referencës (si më poshtë):



YMCA

TERMAT E REFERENCËS (TeR)

Lloji i shërbimit të kërkuar: 1 Trajner/e

Shuma total e ditëve të punës: 8 ditë

Periudha e punës: 15 Prill, 2022 – 15 Maj, 2022 (ditët e punës janë të shpërndara gjatë kësaj periudhe)

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Përmes këtij projekti të rinjtë dhe të rejat do të kenë mundësi të i ngrisin aftësitë e shekullit 21 dhe të mësojnë për vlerat dhe mundësitë e punës.

Komponentët kryesore të programit të YMCA-së janë si në vijim:

- Të kontribuojmë në zhvillimin e drejtëpërdrejtë të aftësive të rinisë.
- Të ndihmojmë të rinjtë/rejat të bëhen më të punësueshëm.
- Të ndikojmë në vetëbesim përmes mentorimeve.
- Të krijojmë hapësirë që të rinjtë/rejat të fitojnë aftësi për punësim ose vetëpunësim.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT E TRAJNERIT/ES

Shërbimet të cilat duhet të ofrohen nga Trajneri/ja për OJQ-në YMCA Movement – YMCA Lëvizje, më konkretisht duhet të sigurohet ekspertiza si në vijim:

- Organizon dhe udhëheq trajnimet në ndërmarrësi për të rinjtë/rejat.
- Mbështet procesin e krijimit të një Plani të Biznesit nga të rinjtë/rejat pas përfundimit të trajnimit.
- Ngrit vetëdijen e të rinjëve/rejave për rëndësinë e punësimit dhe ndërmarrësinë.
- Koordinon dhe monitoron trajnimin, angazhimet e të rinjëve/rejave, përgatitë agjendat dhe prezantimet e nevojshme për trajnime.
- Përgatit dhe harton raport pas përfundimit të trajnimeve.
- Siguron qasjen në literatura të nevojshme për të rinjtë/rejat pjesëmarrës.

REZULTATET E PRITURA NGA TRAJNERI/TRAJNERJA



1. Të përgatisë trajnimet në ndërmarrësi dhe prezantimet e nevojshme.
2. Hartimin e metodologjisë së trajnimit do të duhet të dorëzojë tek YMCA për miratim.
3. Monitorimin e procesit të përgatitjes së një Plani të Biznesit nga të rinjtë/rejat.
4. Dorëzimi i raportit përfundimtar i përmbledhur me të gjitha aktivitetet të paraparë (duke përfshirë, agjendën, prezantimet e planifikuara)

Detyrat, përgjegjësitë dhe rezultatet e pritura nga trajneri/trajnerja të përshkruara më sipër janë të përcaktuara vetëm në terma të përgjithshme. Kjo mund të zgjatet dhe të rregullohen në bazë të nevojave dhe kërkesave që dalin nga fusha/terreni.

PROFILI I/E TRAJNERIT/ES

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Të posedojë fakultetin Bachelor, e preferueshme Master në Ekonomi, Ndërmarrësi, Administrim/Menaxhim Biznesi apo në fusha të ngjashme;
- Të flasë rrjedhshëm në gjuhën Shqipe dhe Angleze, gjuha Serbe mund të jetë përparësi (**raportimi bëhet në gjuhën Shqipe**);
- Aftësi të mira kompjuterike (Paketa e Microsoft office dhe Excel);

Përvoja relevante

- Përvojë të dëshmuar në ofrimin e trajnimeve, organizimeve, prezantimeve për grupet e synuara direkte të projektit;
- Përvojë në hartimin e Planit të Bizneseve;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi;
- Të jetë miqësor ndaj të rinjve/reja dhe i/e aftë për të krijoj atmosferë të përshatshme për ata/ato.

YMCA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë kandidatët dhe inkurajon aplikime për trajnere femrat, si dhe trajner/e nga komunitetet jo-shumicë në Kosovë.

